



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
BERAT

Nr. 225

Data 15/12/2022

NJOFTIM

PER SHPALLJE KONKURIMI PER LEVIZJE PARALELE DHE PRANIM
NE SHERBIMIN CIVIL GJYQESOR

Bazuar ne Ligjin nr. 98/2016 date 06.10.2016 ``Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise``, Vendimin e KLGJ-se Nr. 622 date 10.12.2020 ``Per Levizjen paralele, ngritjen ne detyre dhe pranimin ne sherbimin civil gjyqesor``, udhezimi nr. 85 date 11.03.2021, si dhe vendimit nr. 166 date 14.09.2022 ``Per nderprejten e marredhenieve ne sherbimin civil gjyqesor``, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat, shpall konkurimin

1 (një) pozicion – SEKRETAR GJYQESOR, kategoria IV-a.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

29.12.2022

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

05.01.2023

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin sekretar gjyqësor është:

- Merr për veprim dhe administrim te përkohshem te gjithë fashikujt e çështjeve per gjykim, caktuar gjyqtarit.



- b. Kryen te gjitha veprimet teknike dhe proceduriale per cdo fashikull gjyqesor, ben njoftimet per shpalljen e dates se gjykimit te vendosur nga trupi gjykues, si dhe merr çdo mase per sigurimin normal te gjykimit.
- c. Ben njoftimet e paleve per shpallje.
- d. Verteton aktet e gjykates dhe leshon kopje te njehsuara me origjinalin e akteve proceduriale gjyqesore.
- e. Zbaton urdherimet e gjyqtarit a trupit gjykues per kalimin e çeshtjes ne veprime perгатitore, ne gjyq dhe vendimet e ndermjetme gjate séances.
- f. Sekretarit te seances u ndaloher t'u jape paleve dhe mbrojtesve te tyre, personave te tjere te interesuar per ceshtjen ne gjykim, akte te cfaredo lloji qe ndodhen ne fashikullin gjyqesor. Per riprodhimin e akteve, leshimin e ekstrakteve apo te fotokopjeve per dokumentacionin qe ndodhet ne dosje, sekretari i séances vepron vetem me urdher ose vendim te gjyqtarit/ trupit gjykues.
- g. Sekretari i séances ka pergjegjesi te veçante ne mbajtjen e process - verbaleve gjyqesore. Gjate mbajtjes se tij ai duhet te marre ne menyre te plote identitetin e te pandehurve ose te paleve ne procesin civil, daten, oren dhe vendin e séances gjyqesore, deklarimet e paleve, prokurorit, mbrojtesve, deshmitareve, eksperteve, duke rregjistruar cdo gje qe ka rendesi per çeshtjet, te gjitha urdherimet e trupit gjykues dhe vendimet e tij te ndermjetme.
- h. Mban process-verbalin e seances gjyqesore sipas kerkesave te Kodit te Proçedures Penale dhe te Kodit te Proçedures Civile.
- i. Riprodhon me besnikeri theniet e pjesmarresve ne proces.
- j. Sekretari i seances lidh ne menyre kronologjike dokumentacionin sipas kohes se paraqitjes dhe sipas aktet proceduriale sipas kohes se krijimit.
- k. Merr masa qe fashikulli gjyqesor te jete i lidhur dhe i numertuar.
- l. Ben shenimin perkates te dispozitivit te vendimit ne numërorin e vendimeve penale, ate te masave te sigurise dhe kekresave penale.
- m. Pasqyron ne sistemin elektronik vendimin e zbardhur.
- n. Respekton te gjithë mbarëevajtjen e punes referuar rregullave te etikes dhe te sjelljes.
- o. Perveç detyrave proceduriale, sekretari i seances, kryen dhe detyra te tjera me karakter administrative te percaktuar ne ligj, te autorizuar nga Kryetari, keshilli i Gjykates ose Kancelari, ne Rregulloren e Institucionit, ose ne pershkrimet e punes te miratuara nga KLGJ.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brënda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;



- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën 1 vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira të përdorimit të kompjuterit.
- d. Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etike të lartë komunikimi me të gjithë marrësit e shërbimit të Gjykatës, brenda dhe jashtë saj.
- e. Të jetë i aftë për të kryer në kohë detyrat e ngarkuara.
- f. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
 - CV e përditësuar.
 - Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
 - Fotokopje të librezës së punës.
 - Fotokopje të certifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
 - Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
 - Vërtetim i gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
 - Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
 - Fotokopje e kartës së identitetit.
 - Vërtetim banimi.
 - Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ose nepermjet shërbimit postar brenda datës **29.12.2022 ora 16:00.**

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30.12.2022**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgi.al dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Kancelari njofton kandidatet e kualifikuar datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.



Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës

II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që



nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “*Bachelor*”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën 1 vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën ose prokurorinë.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira të përdorimit të kompjuterit.
- d. Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etike të lartë komunikimi me të gjithë marrësit e shërbimit të Gjykatës, brenda dhe jashtë saj.
- e. Të jetë i aftë për të kryer në kohë detyrat e ngarkuara.
- f. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
 - CV e përditësuar.
 - Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
 - Fotokopje të librezës së punës.
 - Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
 - Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
 - Vërtetim i gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
 - Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
 - Fotokopje e kartës së identitetit.
 - Vërtetim banimi.
 - Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Vertetim Gjykate
- Vertetim Prokurorie.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.


Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ose nepermjet shërbimit postar brenda datës **05.01.2023**

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

KLJG do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive sekretare gjyqësore

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.



Kancelari njofton kandidatet datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim nga Komisioni i Pranimit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e s'kualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Kancelari njofton kandidatet për intervisten e strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Kodi i Procedurës Civile;
- b. Kodi i Procedurës Penale;
- c. Ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë",
- d. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë listen në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:



- Për publikimin e listes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim
- Për publikimin e listes së rezultateve të testimit me shkrim
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me gojë.
- Për publikimin e listes së rezultateve të testimit me gojë

Keshilli arsyeton dhe publikon vendimin për rezultatet e procedurës së pranimit brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës së kandidatëve, dhe pasi merr mendimin me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin dhe ben aktin e emerimit paraprak duke njoftuar pa vonese KLGJ.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës Berat.

PER KESHILLIN E GJYKATES

ANETAR
Sokol MYFTARI

ANETAR
Pëllumb ZAIM

ZV KRYETARE
Matilda LLANGOZI

